LIGJ
Nr.10 285, datë 3.6.2010

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ESTONISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Estonisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6603, datë 17.6.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTË
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ESTONISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Estonisë;

me dëshirën, me qëllim zhvillimin dhe lehtësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike, për të përfunduar një Konventë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Personat e përfshirë

Kjo Konventë do të zbatohet për persona të cilët janë rezidentë të një ose të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2
Tatimet e përfshira

1. Kjo Konventë zbatohet për tatimet mbi të ardhurat, të vëna në emër të një shteti kontraktues ose të autoriteteve të tij lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën ato vilen.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet e vëna mbi të ardhurat në tërësi ose elemente të të ardhurave, duke përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet Konventa, në veçanti janë:

a) në Shqipëri:

i) tatimi mbi të ardhurat (duke përfshirë tatimet mbi fitimin e personave juridikë dhe tatimet mbi të ardhurat personale); dhe

ii) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

b) në Estoni: tatimet mbi të ardhurat.

4. Konventa zbatohet gjithashtu për çdo tatim të njëjtë ose në thelb të ngjashëm që është vendosur pas datës së nënshkrimit të Konventës, si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me çdo ndryshim thelbësor që është bërë në legjislacionin e tyre tatimor.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) Termat “një shtet kontraktues” dhe “shteti tjetër kontraktues” është Shqipëria ose Estonia, siç e kërkon konteksti;

b) Termi “Shqipëri” nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila sipas ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

c) Termi “Estoni” është Republika e Estonisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, përfshin territorin e Estonisë dhe çdo zonë të shtrirë tej kufijve të ujërave territoriale të Estonisë, brenda së cilës, sipas ligjeve të Estonisë dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, mund të ushtrohen të drejtat e Estonisë në lidhje me shtratin e detit dhe nëntokën, dhe burimet e tyre natyrore;

d) Termi “person” nënkupton një individ, shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

e) Termi “shoqëri” nënkupton çdo person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

f) Termat “ndërmarrje e një shteti kontraktues” dhe “ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues” nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues;

g) Termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije ose avion të operuar nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues, përveç kur anija ose avioni operohen vetëm midis vendndodhjeve në shtetin tjetër kontraktues;

h) Termi ”autoritet kompetent” nënkupton:

i) në Shqipëri, Ministrinë e Financave;

ii) në Estoni, Ministrin e Financave ose përfaqësuesin e tij të autorizuar.

i) Termi "shtetas" nënkupton:

i) çdo individ që ka shtetësinë e një shteti kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që e marrin statusin si të tillë nga ligjet në fuqi në një shtet kontraktues.

2. Përsa i përket zbatimit të Konventës në çdo kohë nga një shtet kontraktues, çdo term i papërkufizuar në të, përsa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka pasur në atë kohë sipas ligjit të atij shteti për qëllime tatimore për të cilat zbatohet kjo Konventë. Çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti ka përparësi mbi një kuptim të dhënë termit

sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

Neni 4
Rezident

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “rezident i një shteti kontraktues” nënkupton çdo person i cili sipas ligjeve të atij shteti, u nënshtrohet tatimeve përkatëse për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit të menaxhimit, vendit të themelimit, vendit të regjistrimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin asnjë person që i nënshtrohet tatimit në atë shtet në lidhje vetëm me të ardhurat nga burimet në atë shtet.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident në të dy shtetet kontraktuese, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) Ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka një banesë të përhershme në dispozicion.

b) Nëse ka një banesë të përhershme në dispozicion në të dy shtetet, apo nëse ai nuk ka ndonjë banesë të përhershme në asnjë shtet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetikë).

c) Nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetikë nuk mund të përcaktohet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka një vendqëndrim të zakonshëm.

d) Nëse ka vendqëndrim të zakonshëm në të dy shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit shtetas i të cilit ai është.

e) Nëse ai është shtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet përgjegjëse të shteteve kontraktuese zgjidhin çështjen me marrëveshje reciproke.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dy shteteve kontraktuese, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese e zgjidhin çështjen me marrëveshje të përbashkët.

Neni 5
Seli e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend të qëndrueshëm biznesi, nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi,

b) një degë,

c) një zyrë,

d) një fabrikë,

e) një punishte, dhe

f) një minierë, një pus nafte ose gazi, një gurore ose një vend tjetër të nxjerrjes së burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” gjithashtu përfshin:

a) një shesh ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi apo aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me të, por vetëm kur ky shesh, projekt ose aktivitet vazhdon për një periudhë prej më shumë se nëntë muaj, që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës; dhe

b) dhënien e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur aktivitetet e asaj natyre vazhdojnë në shtetin tjetër kontraktues për një periudhë ose periudha që përbëjnë më shumë se gjashtë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme”

konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për qëllim të vazhdimit nga ana e ndërmarrjes, të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët "a" deri "e", me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, për të cilin zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka dhe ushtron rregullisht në një shtet kontraktues autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje do të konsiderohet të ketë një seli të përhershme në atë shtet në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, përveç kur aktivitetet e atij personi janë të kufizuara në ato që përmenden në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënin këtë të fundit seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet të ketë seli të përhershme në një shtet kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti me autorizim të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë sipas rregullave standarde të biznesit të tyre. Megjithatë, nëse aktivitetet e këtij agjenti i dedikohen plotësisht ose pothuaj plotësisht ndërmarrjes, ai nuk konsiderohet të jetë agjent me status të pavarur sipas kuptimit të këtij paragrafi.

7. Thjesht fakti që një shoqëri e cila është rezidente e një shteti kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri, e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues ose që zhvillon biznes në atë shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose ndryshe), nuk tregon që një prej këtyre shoqërive është seli e përhershme e shoqërisë tjetër.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme

1. Të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria) që gjenden në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Termi "pasuri e paluajtshme" ka kuptimin që ka sipas ligjit të shtetit kontraktues në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, termi përfshin pasurinë, aksesorë të pasurisë së paluajtshme, çdo të drejtë pretendimi në lidhje me pasurinë e paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën, uzufruktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse si shpërblim për punën, ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe burimet e tjera natyrore. Anijet, barkat dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, lënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e

paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, të përdorura për realizimin e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7
Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç rasteve kur ndërmarrja zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm për ato që i takojnë asaj selie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një shteti kontraktues zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje, kësaj selie të përhershme në çdo shtet kontraktues do t'i atribuohen fitimet që mund të pritet të nxjerrë nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen, seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, lejohen si zbritje shpenzimet që janë bërë për qëllime të biznesit të selisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative të kryera në shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose diku tjetër.

4. Për sa kohë që është e zakonshme në një shtet kontraktues të përcaktohen fitimet që i atribuohen një selie të përhershme mbi bazën e një ndarjeje të fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesë të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 nuk përjashton atë shtet kontraktues nga përcaktimi i fitimeve që do të tatohen nga kjo ndarje, siç mund të jetë e zakonshme; megjithatë, metoda e zbatuar për ndarjet do të jetë e tillë që rezultati të jetë në pajtim me parimet në përmbajtje të këtij neni.

5. Asnjë fitim nuk i atribuohet një selie të përhershme për shkak vetëm të blerjes nga ajo seli e përhershme të mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, fitimet që i atribuohen selisë së përhershme përcaktohen me anë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj Konvente, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8
Transporti ndërkombëtar

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues nga operimi i anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen gjithashtu për fitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare.

Neni 9
Ndërmarrjet e asociuara

1. Në rastet kur:

a) një ndërmarrje e një shteti kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të shtetit

tjetër kontraktues;

c) dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë të gjitha fitimet që do të ishin nxjerrë, nëse nuk do të ishin ato kushte, nga një ndërmarrje, por që për shkak të atyre kushteve, nuk janë nxjerrë si të tilla, mund të përfshihen në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatohen rregullisht.

2. Kur një shtet kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti dhe përkatësisht taton fitimet për të cilat një ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues është tatuar në atë shtet tjetër, dhe kur një pjesë e fitimeve të përfshira janë fitime, të cilat do të ishin mbledhur nga ndërmarrja e shtetit të parë të përmendur, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm ndaj sasisë së tatimeve të vëna në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, duhet t'u kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj Konvente dhe autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, nëse është e nevojshme, konsultohen me njëra-tjetrën.

Neni 10

Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një firmë që është rezidente e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatohen gjithashtu në shtetin kontraktues në të cilin është rezidente firma që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është një shoqëri (e ndryshme nga ortakëri) që ka drejtpërdrejt të paktën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët;

b) 10 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk cenon tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhen dividendët.

3. Termi "dividendë" siç përdoret në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera, që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime, si dhe të ardhura nga të drejta të tjera të shoqërisë, të cilat i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet sipas ligjeve të shtetit në të cilin firma që bën shpërndarjen, është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur në të dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazën fikse. Në këtë rast, zbatohen, sipas rastit, dispozitat e nenit 7 ose 14.

5. Kur një shoqëri e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga shteti tjetër kontraktues, ai shtet tjetër nuk mund të vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij shteti tjetër ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët, është efektivisht e lidhur me selinë e përhershme ose një bazë fikse të vendosur në atë shtet tjetër, dhe as nuk do t'i nënshtrojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një tatimi mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë shtet tjetër.

Neni 11
Interesi

1. Interesi i nxjerrë në një shtet kontraktues dhe që i paguhet një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të tatohet në shtetin kontraktues në të cilin ai lind dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë 5 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, çdo interes i përmendur në paragrafin 1 tatohet vetëm në shtetin kontraktues, ku pronari përfitues i interesit është rezident nëse ky interes paguhet:

a) në favor të ose nga qeveria e një shteti kontraktues, autoritet i tij lokal ose banka qendrore;

b) për një hua të çdo lloji të dhënë, siguruar ose garantuar nga qeveria e një shteti kontraktues, autoritet i tij lokal ose banka qendrore.

4. Termi “interes” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i siguruar apo jo me hipotekë dhe nëse ka apo jo të drejtë për të marrë pjesë në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga obligacionet ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë premiet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve dhe dëftesave të borxhit. Termi “interes” nuk përfshin asnjë të ardhur që trajtohet si dividend në bazë të dispozitave të nenit 10. Gjobat për vonesat në pagesa nuk llogariten si interes për qëllim të këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe detyrimi i borxhit në lidhje me të cilin është paguar interesi, është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

6. Interesi konsiderohet të lindë në një shtet kontraktues kur paguesi është vetë shteti, një autoritet lokal i tij ose një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur një person që paguan interesin, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë interesi konsiderohet të lindë në shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.

7. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke marrë parasysh detyrimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënie, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Konvente.

Neni 12
Tarifat e licencave

1. Tarifat e licencave që lindin në një shtet kontraktues dhe që i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto tarifa të licencave mund të tatohen gjithashtu në shtetin kontraktues në të cilin ato lindin dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i tarifave të

licencave është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë 5 për qind të shumës bruto të tarifave të licencave.

3. Termi “tarifat e licencave” siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, çdo patentë, markë tregtare, disenjo ose model, plan, formulë sekrete ose proces, ose për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i tarifave të licencave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lindin tarifat e licencave, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose pasuri në lidhje me të cilat paguhen tarifat e licencave, është e lidhur efektivisht me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

5. Tarifat e licencave konsiderohen të lindin në një shtet kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan tarifat e licencave, rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën është shkaktuar detyrimi për të paguar tarifat e licencave dhe këto tarifa përballohen nga kjo seli e përhershme ose vend fiks, atëherë këto tarifa do të konsiderohen të lindin në shtetin në të cilin është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e tarifave të licencave, duke marrë në konsideratë përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato janë paguar, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Konvente.

Neni 13

Fitimet e kapitalit

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 6 dhe të ndodhur në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Fitimet e përftuara nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve ose interesave të krahasueshme, që marrin më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre drejtpërdrejt ose jo nga pasuria e paluajtshme që gjendet në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që përbëjnë pjesë të pasurisë së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose të pasurisë së luajtshme që i përket një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë fitimet nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme ose të kësaj baze fikse, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

4. Fitimet e përftuara nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues që përdor anije ose avionë në trafikun ndërkombëtar nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar ose pasurisë së luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve ose avionëve, do të tatohen vetëm në atë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie, të ndryshme nga ajo e përmendur në paragrafët e mësipërm të këtij neni, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14
Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat që përftohen nga një individ, i cili është rezident i një shteti kontraktues në lidhje me shërbimet profesionale ose aktivitete të tjera të një karakteri të pavarur, janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç rrethanave të mëposhtme kur këto të ardhura mund të tatohen edhe në shtetin tjetër kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse që i vihet atij rregullisht në dispozicion në shtetin tjetër kontraktues për qëllim të kryerjes së aktiviteteve të tij; në atë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të tatohet në atë shtet tjetër; ose

b) nëse qëndrimi i tij në shtetin tjetër është për një periudhë ose periudha që tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës; në atë rast, vetëm ajo sasi të ardhurash që rrjedh nga aktivitetet e tij të kryera në atë shtet tjetër, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose didaktike, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, auditëve dhe kontabilistëve.

Neni 15
Shërbimet personale të varura

1. Në bazë të dispozitave të nenit 16, 18 dhe 19, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet, nëse punësimi nuk ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim që përftohet atje mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi i përftuar nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, do të jetë i tatueshëm vetëm në shtetin e përmendur më parë, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) marrësi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore, e cila fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës;

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër;

c) shpërblimi nuk përballohet nga një vendqëndrim i përhershëm ose bazë fikse, të cilën punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përftuar në lidhje me një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni të operuar në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues mund të tatohet në atë shtet.

Neni 16
Tarifat e drejtuesve

Tarifat e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve të një shoqërie, e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

Neni 17
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues si një argëtues, artist teatri, filmi, radioje ose televizioni, muzikant apo sportist, në veprimtarinë e tij personale të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një argëtues ose sportist në cilësinë e tij si të tillë nuk përftohen nga subjekti argëtues ose sportisti, por nga një person tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e argëtuesit apo sportistit.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga aktivitetet e ushtruara në një shtet kontraktues nga një artist ose sportist nëse vizita në atë shtet kontraktues është tërësisht ose pjesërisht e mbështetur nga fondet publike të një ose të dy shteteve kontraktuese ose autoritetet lokale të tij. Në këtë rast, të ardhurat tatohen në shtetin kontraktues në të cilin është rezident artisti ose sportisti.

Neni 18
Pensionet

Pensionet dhe shpërblime të ngjashme të paguara një rezidenti të një shteti tjetër kontraktues do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

Neni 19
Shërbimi qeveritar

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, përveç pensionit, që një shtet kontraktues apo autoritet vendor i paguan një individi në lidhje me shërbimet që i janë bërë atij shteti apo autoriteti, tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto paga ose shpërblime të tjera të ngjashme do të jenë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe nëse individi është rezident i atij shteti dhe që:

i) është shtetas i atij shteti; ose

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. Dispozitat e neneve 14, 15, 16 dhe 17 do të zbatohen për rrogat, pagat, dhe shpërblime të tjera të ngjashme, në lidhje me shërbimet e kryera për një biznes të zhvilluar nga një shtet kontraktues ose autoritet lokal i tij.

Neni 20
Studentët

Pagesat që merr një student, nxënës ose stazhier, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës në shtetin kontraktues, rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe që është i pranishëm në shtetin e parë vetëm për qëllime të edukimit ose trajnimit të tij, që merren për qëllimet e mbështetjes ekonomike, edukimit ose trajnimit të tij nuk do të tatohen në atë shtet, me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë atij shteti.

Neni 21
Të ardhura të tjera

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një shteti kontraktues, në çdo kohë që ato lindin, të patrajtuara në nenet e mësipërme të kësaj Konvente, do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të

ardhurave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhen të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

Neni 22
Eliminimi i tatimit të dyfishtë

Tatimi i dyfishtë eliminohet si më poshtë:

1. Në Shqipëri:

Nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura që, në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatohen në Estoni, Shqipëria lejon si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Estoni. Megjithatë kjo zbritje nuk tejkalon atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat që llogariten para se të bëhet zbritja që, sipas rastit, i përket të ardhurave që mund të tatohen në Estoni.

2. Në Estoni:

a) Nëse një rezident i Estonisë përfton të ardhura, që në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente, tatohen në Shqipëri, Estonia, në pajtim me dispozitat e nënparagrafëve “b” dhe paragrafin 3, i përjashton këto të ardhura nga tatimi.

b) Nëse një rezident i Estonisë merr të ardhura që në pajtim me dispozitat e:

i) nënparagrafit “b” të paragrafi 2 të nenit 10; ose

ii) paragrafit 2 të nenit 11 ose 12;

- mund të tatohen në Shqipëri, Estonia lejon si një zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat e paguara në Shqipëri. Megjithatë kjo zbritje nuk tejkalon atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat në Estoni që llogariten para se të bëhet zbritja, që i përket të ardhurave që mund të tatohen në Shqipëri.

3. Nëse në pajtim me një dispozitë të Konventës, të ardhurat e përftuara nga një rezident i një shteti kontraktues përjashtohen nga tatimet në atë shtet, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të këtij rezidenti, ai megjithatë merr parasysh të ardhurat e përjashtuara.

4. Nëse, në pajtim me të drejtën e një shteti kontraktues, përjashtimi nga ose ulja e tatimeve që mbulohen nga kjo Konventë jepet për të inkurajuar zhvillimin ekonomik të atij shteti kontraktues, ky tatim konsiderohet të jetë paguar për qëllimet e paragrafëve të mësipërm të këtij neni. Autoritetet kompetente njoftojnë njëra-tjetrën për këto përjashtime ose lehtësime apo ndryshimet në to.

Neni 23
Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një shteti kontraktues nuk i nënshtrohen në shtetin tjetër kontraktues asnjë tatimi apo kërkese që lidhet me të, që është e ndryshme ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat në lidhje me të, të cilat u nënshtrohen apo mund t’u nënshtrohen shtetasit e shtetit tjetër në të njëjtat rrethana, sidomos në lidhje me rezidencën.

2. Tatimi mbi një seli të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë shtet tjetër sesa tatimi i vendosur mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që zhvillon të njëjtat aktivitete.

3. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, të paragrafit 7 të nenit 11 ose të paragrafit 6 të nenit 12, interesi, tarifat e licencave dhe disbursime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të

përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur më parë.

4. Ndërmarrjet e një shteti kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose zotërohet tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo nga një ose më shumë rezidentë të shtetit tjetër kontraktues, nuk i nënshtrohet asnjë tatimi në shtetin e përmendur më parë dhe asnjë kërkese në lidhje me të, që është e ndryshme ose më e rëndë se tatimi dhe kërkesat e ngjashme të cilave mund t'u nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur më parë.

5. Dispozitat e këtij neni nuk interpretohen si detyrim për një shtet kontraktues për t'u dhënë rezidentëve të shtetit tjetër kontraktues honorare, lehtësime dhe ulje personale për qëllime tatimore për shkak të gjendjes civile ose përgjegjësive familjare që u jep rezidentëve të tij.

6. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht dispozitave të nenit 2, nuk zbatohen për tatime që i nënshtrohen kësaj konvente.

Neni 24

Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë

1. Kur një person konsideron se veprimet e një ose të dy shteteve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident ose nëse çështja e tij trajtohet në paragrafin 1 të nenit 23, të shtetit kontraktues në të cilin është shtetas. Çështja mund të paraqitet brenda tri vjeteve nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatimin në mospajtim me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent, nëse mendon që kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, përpiqet të zgjidhë me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me qëllim mënjanimin e tatimit që nuk është në pajtim me këtë Konventë. Marrëveshja lidhet për një periudhë dyvjeçare pas ngritjes së çështjes formalisht nga autoriteti kompetent dhe marrëveshja e arritur zbatohet pavarësisht afateve kohore në ligjin e brendshëm të shteteve kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet të cilat nuk janë parashikuar në Konventë.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të komunikojnë me njëra-tjetrën në mënyrë të drejtpërdrejtë, për qëllim të arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

Neni 25

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose për administrimin ose zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi të vendosur në emër të shteteve kontraktuese ose autoriteteve lokale, në masën që tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një shtet kontraktues trajtohet si konfidencial në të njëjtën mënyrë si informacioni i përftuar sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe u deklarohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me ose përcaktimin e ankimeve në lidhje me tatimet e përmendura në paragrafin 1, ose mbikëqyrjen sa më sipër. Këta persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata

mund ta deklarojnë informacionin në gjykime me dyer të hapura ose vendime gjyqësore.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk interpretohen sikur vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të shtetit tjetër kontraktues;

b) për të siguruar informacion që nuk mund të merret sipas ligjeve ose në rrugën normale të administratës së tij ose të shtetit tjetër kontraktues;

c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial ose profesional ose proces tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse informacioni kërkohet nga një shtet kontraktues në pajtim me këtë nen, shteti tjetër kontraktues zbaton masat për mbledhjen e informacionit të kërkuar edhe nëse këtij shteti nuk i duhet ky informacion për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi i parashikuar në fjalinë e mësipërme i nënshtrohet kufizimit të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të mos japë informacion vetëm pasi ai nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

5. Në asnjë rast dispozita e paragrafit 3 nuk interpretohet sikur lejon një shtet kontraktues të mos japë informacion vetëm pasi informacioni zotërohet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i emëruar ose person që vepron në një agjenci ose në cilësi mirëbesimi ose për shkak se ka të bëjë me interesa pronësie të një personi.

Neni 26

Asistenca në mbledhjen e tatimeve

1. Shtetet kontraktuese i japin njëra-tjetrës asistencë në mbledhjen e pretendimeve të të ardhurave. Kjo asistencë nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të zgjidhin me marrëveshje reciproke mënyrën e zbatimit të këtij neni.

2. Termi “pretendim për të ardhura” i përdorur në këtë nen është shuma që duhet të paguhet në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi të caktuar në emër të shteteve kontraktuese ose autoriteteve lokale, nëse tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me këtë Konventë ose një instrument ku janë palë dy shtetet kontraktuese, si dhe interesat, gjobat administrative dhe shpenzimet e mbledhjes dhe ruajtjes së një shume të tillë.

3. Nëse një pretendim për të ardhura i një shteti kontraktues është i ekzekutueshëm sipas ligjeve të atij shteti dhe është në pronësi të një personi që, për momentin, sipas ligjeve të atij shteti, nuk mund të pengojë vjeljen e tij, ai pretendim për të ardhura, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti, mund të pranohet për qëllimet e mbledhjes nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues. Pretendimi për të ardhura realizohet nga shteti tjetër në pajtim me dispozitat e ligjit të tij që zbatohen për zbatimin dhe mbledhjen e tatimeve të veta sikur pretendimi për të ardhura të ishte pretendim i atij shteti tjetër.

4. Nëse një pretendim për të ardhura i një shteti kontraktues është një pretendim në lidhje me të cilin ai shtet, në bazë të ligjeve të tij, mund të marrë masa ruajtjeje për të siguruar vjeljen, ai pretendim për të ardhura, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti, pranohet për qëllimet e marrjes së masave të ruajtjes nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues. Shteti tjetër kontraktues merr masa për ruajtjen në lidhje me atë pretendim për të ardhura në pajtim me dispozitat e ligjeve të tij sikur pretendimi për të ardhura të ishte një pretendim i atij shteti tjetër edhe nëse, në momentin kur zbatohet një masë e tillë, pretendimi për të ardhura nuk është i zbatueshëm në shtetin e parë ose duhet të paguhet nga një person që ka të drejtë të pengojë vjeljen.

5. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 3 dhe 4, një pretendim për të ardhura që pranohet nga një shtet kontraktues për qëllimet e paragrafit 3 ose 4, në atë shtet, nuk u nënshtrohet kufijve kohorë apo t’i jepet ndonjë prioritet që zbatohet për pretendimin e të

ardhurave sipas ligjeve të atij shteti për shkak të natyrës së tij si i tillë. Përveç kësaj, një pretendim për të ardhura i pranuar nga një shteti kontraktues për qëllimet e paragrafëve 3 ose 4, në atë shtet, nuk ka prioritet të zbatueshëm për atë pretendim të ardhurash sipas ligjeve të shtetit tjetër kontraktues.

6. Çështjet në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose shumën e një pretendimi për të ardhura të një shteti kontraktues nuk sillen para gjykatave ose organeve administrative të shtetit tjetër kontraktues.

7. Nëse në një moment, pasi është bërë një kërkesë nga një shtet kontraktues sipas paragrafit 3 ose 4 ose para se shteti tjetër kontraktues të ketë mbledhur ose dërguar pretendimin për të ardhurat përkatëse shtetit të parë, pretendimi për të ardhura pushon së ekzistuari:

a) në rastin e një kërkese sipas paragrafit 3, një pretendim për të ardhura i shtetit të parë që është i zbatueshëm sipas ligjeve të atij shteti dhe është i një personi që, për momentin, sipas ligjeve të atij shteti, nuk mund të pengojë vjeljen e tij; ose

b) në rastin e një kërkese sipas paragrafit 4, pretendimi për të ardhura i shtetit të parë në lidhje me të cilin ai shtet, sipas ligjeve të tij mund të marrë masa ruajtjeje me qëllim sigurimin e vjeljes, autoriteti kompetent i shtetit të parë njofton menjëherë autoritetin kompetent të Shtetit tjetër për këtë fakt dhe, sipas zgjedhjes së shtetit tjetër, shteti i parë pezullon ose tërheq kërkesën e tij.

8. Në asnjë rast dispozitat e këtij neni nuk interpretohen sikur vendosin një shtet kontraktues para detyrimit:

a) të zbatojë masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikat administrative të tij ose dhe shtetit tjetër kontraktues;

b) të zbatojë masa që do të ishin në kundërshtim me politikën publike (rendi publik);

c) të japë asistencë nëse shteti tjetër kontraktues nuk ka ndjekur të gjitha masat e arsyeshme për vjeljen ose ruajtjen, sipas rastit, të zbatueshme sipas ligjeve ose praktikës administrative të tij;

d) të japë asistencë në ato raste kur barra administrative për atë shtet është dukshëm joproporcionale krahasuar me përfitimin e marrë nga shteti tjetër kontraktues.

Neni 27

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk do të ndikojë në privilegjet financiare të anëtarëve të misioneve diplomatike ose posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 28

Hyrja në fuqi

1. Qeveritë e shteteve kontraktuese do ta njoftojnë njëra-tjetrën që janë plotësuar procedurat e tyre ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Konvente.

2. Kjo Konventë hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit të përmendur në paragrafin 1 dhe dispozitat e saj do të kenë fuqi në të dy shtetet kontraktuese:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, për të ardhurat që përftohen në 1 janar ose pas 1 janarit të vitit kalendarik të vitit pasardhës kur ka hyrë në fuqi Konventa;

b) në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, tatimet e vjelshme për çdo vit fiskal që fillon më ose pas ditës së parë të janarit pas vitit kur hyn në fuqi Konventa.

3. Për qëllimet e nenit 25, dispozitat do të kenë efekt nga data në të cilën Konventa do të hyjë në fuqi.

Neni 29

Përfundimi

Kjo Konventë mbetet në fuqi derisa të prishet nga një palë kontraktuese. Secila palë kontraktuese mund ta prishë Konventën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke bërë njoftim me shkrim për prishjen të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik pas skadimit të një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes së saj në fuqi. Në një rast të tillë, Konventa pushon së qeni në fuqi:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, mbi të ardhurat e përftuara në ose pas ditës së parë të janarit që pason vitin në të cilin bëhet njoftimi;

b) në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, tatimet e vjelshme për çdo vit fiskal që fillon më ose pas ditës së parë të janarit pas vitit kur bëhet njoftimi.

Në dëshmi sa më sipër, të kësaj të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në dy kopje Tiranë, më 5.4.2010 në gjuhën shqipe, estoneze dhe angleze, ku të dy tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhje ndërmjet teksteve, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.